

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DIBËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**V E N D I M**

Nr. 54 Datë 27/03/2020

**MIRATIMI I NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË DIBËR DHE  
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2020.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore ” dhe në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017. Gjithashtu duke u mbështetur edhe në VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar me VKM nr. 202 datë 15.03.2017, si dhe në vendimin nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, në mbledhjen e datës 27/03/2020 me 20 vota pro, — kundër, — abstenim:

Vendosi:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj, bazuar në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017.

2. Këshilltaret të shpërblehen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave të shpërblehen në masën:

- 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (0-300) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (301-600) banorë
- 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (601-1000) banorë

- 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (+1000) banorë
  - 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (0-300) banorë
  - 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (301-600) banorë
  - 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (601-1000) banorë
  - 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (+1000) banorë
- 

3. Me zbatimin e këtij vendimi do të merret Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETAR KËSHILLIT BASHKIAK

Inva TRUPJA



Sokol SAVA



HECAL M. DIZEKA  
*[Handwritten signature]*